



*VENDIM*

*Nr. 142, Datë 15.08.2016*

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“ENERGY MRKET ALBANIA” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E  
TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma ‘e’ dhe 10 pika 3 të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet per Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjise Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” e Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet per Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjise Elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/8 gërma “a”, “c” dhe “d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘e’;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma “c”);
- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/8 gërma “b”, do të njoftohet aplikuesi që ti paraqesë në ERE brenda afateve ligjore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.